

# AKT THEMELIMI

## I

### Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

### “ JUTEA ” Shpk

#### Neni 1:

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 23/10/2023, ne themelueset , **NERTILA TAKU** dhe **JONIDA SULAJ** kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**JUTEA**” Shpk.

Kjo shoqëri themelohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme

Themeluesit e kompanisë :

- **NERTILA TAKU**, Lindur në Tiranë, më 13/12/1987, me Nr. ID **I76213028P** , banues në Tiranë.
- **JONIDA SULAJ**, Lindur në Cakran, Fier, më 09/12/1989, me Nr. ID **I96209010S** , banues në Vlorë.

#### Neni 2:

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë si më poshtë:

Projektimi,ndërtimi, vënia në shfrytëzim dhe/ose administrimi i komplekseve turistike, strukturave hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale dhe/ose të përhershme, objekteve me destinacion rezidencial si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit/agroturizmit, Bar-Restorant, Stacion Plazhi si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtaritë e sipërpërmenduar.

Shitje, blerje, dhënie me qira të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, Ndërmjetësim për shitjen dhe marketimin e pasurive të paluajtshme dhe aseteve të ndryshme midis personave fizikë, personave juridikë, private, publikë dhe shtetëror si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme.

Objekti i shoqërisë mund të shtohet ose ndryshohet me vendim te ortakut të vetëm. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera së bashku me aktivitetet që i përkasin objektit të shoqërisë, në qoftë se këto aktivitete janë të nevojshme për ekzistencën ose për veprimtarinë e shoqërisë, por nuk përbëjnë aktivitetin e zakonshëm të saj.

#### Neni 3:

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë do të jetë në një periudhë pa afat.

#### Neni 4:

##### Selia

Selia e kompanisë është në adresën: 'Rruga Murat Terbaci, Ndertesa 59, Hyrja 25, apartamenti N6 9405 Vlore'. Me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj dhe për të hapur degë dhe filiale të tjera në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë mund të krijojë, modifikojë apo të anultojë seli sekondare agjensi dhe përfaqësi kudo që e quan të nevojshme edhe jashtë shtetit.

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në 2 kuota, në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:

Kapital financiar 100,000 lekë.

1. Ortak, Themelues: **NERTILA TAKU** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 50 % me vlerë 50,000 Leke.
2. Ortak, Themelues: **JONIDA SULAJ** zotërues i 1 (një) kuote, në masën 50 % me vlerë 50,000 Leke.

#### Neni 6:


##### Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë caktohet : **FERDINANT SULAJ, Lindur në Vlorë, më 20/04/1956, me Nr. ID F60420348D, banues në Vlorë.**

(Emër, Mbiemër, Firmë):




Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"JUTEA"**

**NERTILA TAKU**

Emër mbiemër (nenshkrimi)



**JONIDA SULAJ**

Emër mbiemër (nenshkrimi)

